

KRITIKA E RECENSIONE

I l i a z R e x h a, LIDHJA E PRIZRENIT NË DOKUMENTET OSMANE, Prishtinë, 1978, f. 310, in 8° (botoi Arkivi i Kosovës)

Në qershor të vjetit 1978 u mbushën njëqind vjet nga themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ky përvjetor u shënuar me një varg aktivitete shkenore-kulturore. Arkivi i Kosovës këtë përvjetor me rëndësi të madhe historike e shënoi me dy libra me burime arkivore, që i dedikohen kësaj ngjarjeje të rëndësishme:

1. *Lidhja shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze* përgatitur nga Prof. dr Skënder Rizaj, dhe

2. *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*, për të cilën vepër do të bëjmë fjalë në këtë vështrim.

Libri *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane* përveç në gjuhën shqipe dhe serbokroate mban titullin edhe në gjuhën angleze (The League of Prizrend in old Turkish documents). Lëndës burimore i prin përmbajtja (f. 5-8), parathënia në gjuhën shqipe (9-13), në serbokroatishte (15-18) dhe në gjuhën angleze (f. 19-23). Në parathënie autori ka vu në pah se këta burime u takojnë viteve 1878-1881, dhe se ata flasin për përgatitjen, themelimin, afirmimin, aktivitetin si dhe luftërat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e viseve shqiptare. Autori e njofton hulumtuesin shkencor edhe me botime të mëparshe nga ky lëmi si edhe me fondet e institucionet prej nga janë vjelë materialet, që prezentohen në këtë vëllim. Nga fondet arkivore të Stambollit autori përmend këtu:

Jalldëz, esas evraki, sadaret resmi ma'ruzati dhe irade defterleri.

Në këtë vepër janë botuar 80 (tetëdhjetë) dokumente, që janë numëruar me numra arabë, si: telegrame e raporte konzujsh të ndryshëm përkitazi me këto ngjarje etj. Dokumentet nën numrin 2,5 dhe 10 janë artikuj të shtypit osman. E tërë lënda e botuar paraqet një fond të pasur e me interes të faktologjisë për ngjarjen së cilës i dedikohet vepra.

Ndër materiale të natyrës si: telegrame e shkresa të ndryshme (f. 26-194), dokumenti i datës 14 tetor 1878 (f. 44) sikur rezimon kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në fazën e themelimit dhe të aktivitetit fillestar të saj. Aty thuhej se: *Lidhja Shqiptare ka aprovuar vendimet që të gjitha viset e Arnautllëkut të bashkohen në një vilajet me qendër në njërin nga qytetet e afërta dhe të përshtatshëm për të gjith; të gjith nëpunësit që shërbejnë në krahinat e Arnautllëkut duhet të dijnë edhe gjuhën shqipe; nëpër shkolla të mësohet edhe gjuha shqipe etj.* Këtë dokument e nënshkruan udhëheqës të shquar të Lidhjes Shqiptare.

Një serë dokumentesh hedhin dritë mbi angazhimin e shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për t'i dalë zot atdheut të vet qoftë me armë, me diplomaci, apo me logjikën historike (58-62). Në peticionin dërguar sulltanit, të nënshkruar nga Abdyl Frashëri dhe Mehmet Ali Vrioni, me 23 qershor 1879 vjen në shprehje aftësia diplomatike e udhë-

heqësve shqiptarë. Ata e njohtojnë sultanin me gjendjen momentare por edhe e paralajmërojnë për pasojat e rënda në të ardhmen. Këto pasoja nuk do të jenë të rënda vetëm për shqiptarët por edhe për vet Perandorinë Osmane, sepse: „*nëse ato copëtohen dhe bien nën robërimin e armiqve fqinjë, dihet mirë se edhe vet kryeqendra e Perandorisë Osmane (...) do të dobësohet dhe do të gjendet në rrezik*”.

Përmes këtyre dokumenteve ndriçohet mirë raporti në relacionin: Lidhja Shqiptare e Prizrenit — Perandoria Osmane — Fuqitë e mëdha. Vëhet në pah edhe fakti se komandantëve e strategëve ushtarakë osmanë u duhej përgatitje e posaçme dhe ndihmë e veçant që të mund të shuajnë, të paktën ta shtypin, Lëvizjen e shqiptarëve, që me ngulm kërkonte të drejtat e veta kombëtare.

Në këtë botim ka gjetë vend edhe një procesverbal i qeverisë osmane në të cilin flitet për angazhimin e saj që përmes këshillave dhe bisedimeve t'i bindë shqiptarët t'i pranojnë vendimet e Kongresit të Berlinit. Mirëpo, në anën tjetër e vetëdijshe se shqiptarët nuk do t'i përfillin ato vendime, të cilat ishin vdekjeprurëse, respektivisht pranimi i atyre vendimeve do të thoshte praktikisht vetëvrasje për shqiptarët, po aty urdhëronte (...) *për të lehtësuar dorëzimin* (e vendeve, që Shqipërisë ia shkëpuste Traktati i Berlinit), *duhet të dërgohen sa më shpejt edhe 5000 (pesë mij) ushtarë*”. Vepra, përkatësisht këto burime, mbyllen me projektin e Sami Frashërit ku ai propozonte riorganizimin e qeverisë osmane sipas shembullit evropian. Ai parashihnte reforma, të cilat do të bënin kthesë historike jo vetëm nga aspekti politik e strategjik por edhe nga ai socialo-ekonomik.

Në këtë vepër janë edhe faksimili i dokumentave osmane mirëpo ngatërrimi i numrave, ose rënia krijtësisht e tyre, në disa dokumente, paraqet problem për hulumtuesin i cili don të bëjë krahasimin midis

originalit dhe përkthimit të dokumentit.

Duke përfunduar këtë vështrim për këtë vepër e shohim të udhës t'i hedhim sy dhe të vemë në pah edhe disa lëshime të autorit, përkatësisht të veprës në tërësi, qofshin edhe të lektorit ose të korektorit. Autori është dashur të konstatojë se dokumentet në numrin: 11, 12, 13, 14, 19, 24, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 33 i ka hulumtuar dr Hasan Kaleshi. Gjatë përkthimit, disa herë, pa nevojë e ngarkon përkthimin me shprehjet origjinale që i vë në kllapa, si p.sh. *përfaqësitë* (vükela), *çështje* (mesele), *sipas disa mendimeve* (ba'zi araye göre), *princ i huaj* (ecnebi prens), *drejtorëve* (müdirëve), etj. Madje edhe disa nocione e fjalë të tjera do të kishte qenë më drejt të përktheheshin më lirisht, në frymën e kontekstit, f. v. *cem'iyyet-i ittihadıyye* të përkthehet Komiteti i Lidhjes në vend të Organizatë e Lidhjes, *heyet* në tekstin konkret më drejt do të ishte të përkthehet komision e jo delegacion, *hüsn-i idare* udhëheqje e mirë, e jo administratë e mirë si qëndron në vepër, etj.

Në këtë vepër hasim edhe disa lëshime të vogla që kanë qenë detyrë e lektorit ose korektorit si: ndonjë fjali e shprehje e natyrës joshqipe (f. 57, 65, 190); përsëritja e rreshtave ose rënia e tyre krejtësisht (f. 62), etj.

Megjithatë, mund të përfundojmë se, duke pasur parasysh edhe faktin se për vepra e botime të kësaj natyre na mungon përvoja, libri „Lidhja e Prizrenit në dokumente Osmane” e Iljaz Rexhës, hiç ato pak të meta, është ndihmesë e madhe historiografisë, veçmas për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, të cilës i dedikohet. Meqë libri është mbështetur në burimet arkivore të Stambollit do t'ia rriste vlerën, pa dyshim, sikur të kishte rezy-menë edhe në gjuhën turke, krahas rezy-mesë në anglisht dhe serbokroatisht.

FETI MEHDIU